



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6418 Nr. i faq/Br.str/No.pg 144
Data/Datum/Date 18 / 8 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Procesverbal i takimit të buxhetimit me pjesëmarrje

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e takimit publik të buxhetimit me pjesëmarrje publikua në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz:

<https://www.facebook.com/share/p/14LHCkLVMmR/?mibextid=wwXlfr>

Njoftimi për mbajtjen takimit publik të buxhetimit me pjesëmarrje u publikua më datë 14.08.2025 në këtë vegëz: <https://rahovec.rks-gov.net/news/u-mbajt-takimi-i-pare-i-buxhetimit-me-pjesemarrje/>

Takimi publik me qytetarë i buxhetimit me pjesëmarrje

Takimi i parë publik i buxhetimit me pjesëmarrje me qytetarë, që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 14.08.2025 në Parkun e qytetit, me fillim në ora **11:00**.

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 31

- Femra ishin: 7
- Meshkuj ishin: 24

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këto dëgjime.

Takimin e hapi zyrtarja për Informim në komunën e Rahovecit, **znj. Blerta Gashi**: Të nderuar të pranishëm, mirë se erdhët në takimin e sotëm i cili i është dedikuar buxhetimit me pjesëmarrje

Cka është buxhetimi me pjesëmarrje?

“Buxhetimi me Pjesëmarrje është një proces i cili përfshin drejtpërdrejt vendasit në marrjen e vendimeve për prioritetet e shpenzimeve për një buxhet të përcaktuar publik. Kjo nënkupton angazhimin e banorëve dhe grupeve të komunitetit, përfaqësuesve të të gjitha pjesëve të komunitetit, për t’i diskutuar prioritetet e shpenzimeve, për të bërë propozime për shpenzimet dhe për t’i votuar ato.” Me një fjalë, BP i fuqizon banorët lokal që të luajnë një rol kyç për të vendosur se si shpenzohen paratë publike për projekte dhe shërbime në lagjet e tyre.

Buxhetimi me pjesëmarrje është, në fakt, një proces i bashkë menaxhuar ku përfshihen qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile lokale, qeveria, këshillat lokalë dhe komuniteti biznesor. Procesi i

pjesëmarrjes duhet të sigurojë që grupet e cënueshme (zakonisht qytetarët nga grupet me të ardhura të ulëta, gratë, të rinjtë, fëmijët dhe emigrantët) të angazhohen drejtpërdrejt në të gjitha fazat e BP.

Parimet e buxhetimit me pjesëmarrje janë

- Gjithëpërfshirja dhe fuqizimi i qytetarëve,
- Komunikimi i hapur,
- Transparenca dhe llogaridhënia,
- Përfshirja e qytetarëve dhe votimi demokratik.

Pjesëmarrja në BP është vullnetare dhe të gjitha palët e interesit duhet të gëzojnë mundësi të barabarta për të marrë pjesë.

Pra ju propozoni, loboni në komunitetin që ju e përfaqësoni që ideja dhe projekti juaj është më i miri, pas një jave është dita kur ne mbledhemi dhe votohen projektet pastaj projekti më me shumë vota fiton.

Këtë vit siç e keni pare në njoftimin dhe shpalljen publike komuna ka ndarë 50 mijë euro të cilat janë të dedikuar komplet për buxhetimin me pjesëmarrje. Ju vendosni ku do të shkojnë ato në cilin projekt.

Para se ju të propozoni idetë tuaja më duhet ti cek disa nga kriteret për financimin e projektit fitues:

1. Projekt propozimi duhet të jetë Brenda buxhetit të prezantuar nga komuna në vlerë deri në 50 mijë euro;
2. Numri i përfituesve të projektit të jetë sa i madh dhe gjithëpërfshirës;
3. Lloji i projektit që mund të propozohen: Investime kapitale, shërbime të ndryshme apo intervenime shtesë në projektet eksistuese, projekte turistike, kulturore, rinore dhe sportive;

Tani ftoj kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi për një fjalë rreth buxhetimit me pjesëmarrje.

Smajl Latifi, kryetar i komunës: Të nderuar pjesëmarrës, mirë se keni ardhë në këtë proces të rëndësishëm të buxhetimit me pjesëmarrje, një përpykje për të përfshirë qytetarinë në vendimmarrje. Blerta i dha informatat e nevojshme rreth procesit, pra ju duhet të jepni ide, propozime brenda vlerës 50 mijë euro, ndërsa javën e ardhshme do të votohen propozimet tuaja. Pra, ju propozoni, ju votoni, komuna financon.

Murat Morina: Përshëndetje, pas konsultave me qytetarë të fshatit Malësi e Vogël, ne po propozojmë ndërtimin e parkut në mjediset e shkollës në Malësi të Vogël.

Ali Hoxha: I nderuar kryetar, propozimi im është “Rregullimi i tregut në lagjen e Epërme”.

Shaip Shala: Unë po i qëndroj propozimit tim që e kam dhënë vitin e kaluar, “Ndërtimi i obeliskut te Epopeja e UÇK-së në Rahovec.

Leart Emini, nxënës: Përsëritet, jam nxënës në shkollën Xhelal Hajda Toni, shkolla jonë ka nevojë për kabinete të teknologjisë, andaj dhe unë po e propozoj këtë ide.

Skënder Krasniqi, përfaqësues i fshatit Opterushë: Përsëritet, Opterusha investimin më me prioritet e ka hapjen e lumit, po shpresoj që do ta kemi një zgjidhje me anë të këtij procesi.

Smajl Latifi, kryetar i komunës: Tani duhet ti analizojmë nëse ka propozime që janë në kontrata ekzistuese, duhet ti përjashtojmë, sepse duhet të jenë projekte të reja. Tregu do të jetë pjesë e sheshit, tregu te hardh fest është vetëm për prodhuesit e rrushit. Shiriti i tregut është pjesë e rrugës në menaxhimin e Ministrisë, nuk kemi të drejtë të bëjmë 3 tregje në 10 km katror. Ndërtimi i obeliskut mund të jetë e mundshme. Ne kemi kontratë aktive për kabinete, ide e mire, por jo për buxhetimin me pjesëmarrje. Po ju ftoj edhe për dy propozime tjera.

Leart Emini, nxënës: Në shkollën Xhelal Hajda Toni, duke marrë parasysh vullnetin e mirë të profesorëve për të mbajtur orë mësimore në ambiente të hapura, po propozoj “Furnizimi me shporta për mbeturina dhe ndërtimi i një klase verore në shkollën Xhelal Hajda-Toni”

Propozimet që janë paraqitur për diskutim ishin si më poshtë:

1. Ndërtimi i parkut në mjediset e shkollës në Malësi të Vogël;
2. Rregullimi i tregut në lagjen e Epërme;
3. Ndërtimi i obeliskut te Epopeja e UÇK-së në Rahovec;
4. Hapja e lumit në Opterushë;
5. Furnizimi me shporta për mbeturina dhe ndërtimi i një klase verore në shkollën Xhelal Hajda-Toni.





Zyra për Informim





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimeve për buxhetim me pjesmarrje me qytetarët e Komunës së Rahovecit

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1.	MURAT	MORINA	RADOŠE		
2.	Abdullah	Bellaga	Potaganiç		
3.	ELHAN	MORINA	Xërxë		
4.	Leont	Enin	Rahovec		
5.	Adnan	Reber	RAHOVE		
6.	ELTON	KRASNIQI	OPTERUSHA		
7.	SHYHRETE	KRASNIQI	OPTERUSHA		
8.	Atë L.	Krasniqi	OPTERUSHA		
9.	Zahide	Dula	Pahovec		
10.	Xaile	Paçi	Retije		
11.	Sahade	Dula	Rahovec		
12.	Adelina	Vuçitorna	Rahovec		
13.	ALI	HOXHIA	RAHOVE		
14.	Naser	DULA	RAHOVE		
15.	Shqip	Shala	~ II ~		
16.	Xhaxhi	Jhapruka	L-T Rahovec		
17.	Bojan	Korina	Redoc		
18.	Shqip	Bojan	SPONIA		
19.	Binak	Benika	Hoxe Vogël		
20.	Donat	Korina	Redoc		

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.

Më 14.08.2025, Parku i Qytetit Rahovec



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimeve për buxhetim me pjesmarrje me qytetarët e Komunës së Rahovecit

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1.	NASER	LEORINA	RATKOC		[Signature]
2.	GJILFERIE	LEORINA	RATKOC		[Signature]
3.	Prezon	Bytyqi	Brestovc		[Signature]
4.	Skender	[Signature]	[Signature]		[Signature]
5.	Rinesa	Duka	Rahovec		[Signature]
6.	Emen	Islami	Rahovec		[Signature]
7.	Andion	Romer	Rahovec		[Signature]
8.	BERIM	KRASNIQI	RATKOC		[Signature]
9.	Qendresa	Hoxha	RAHOVEC		[Signature]
10.	Sherder	Hoxha	Rahovec		[Signature]
11.	Alban	Gashi	KRUSHË E MADHE		[Signature]
12.					
13.					
14.					
15.					
16.					
17.					
18.					
19.					
20.					

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.

Më 14.08.2025, Parku i Qytetit Rahovec